



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 277/1 prot.

Tiranë, më 19.04.2019

V E N D I M

Nr.39, Datë 19/04/2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES
VENDORE, BASHKIA VAU I DEJËS DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT
PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vau i Dejës,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 70, datë 04.07.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Vau i Dejës”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin, Bashkia Vau i Dejës.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga Njësia Përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes, nr. 550/1 prot., datë 04.07.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 550/2 prot., datë 04.07.2018, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë

në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Vau i Dejës”, i është njoftuar këtij institucioni.

Bashkia përfshihet si subjekt i mbikëqyrjes së Komisionerit, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 550/6 prot., datë 07.12.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Vau i Dejës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Nëpërmjet shkresës nr. 718 prot., datë 12.2.2019, Bashkia Vau i Dejës, ka shprehur dakortësinë e saj lidhur me të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e evidentuara në projektraport.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Vau i Dejës dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në 57 raste, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar pa konkurrim, në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit:
1. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Kontabilizimit, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 164, datë 16.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
 2. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e të Ardhurave, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 178, datë 09.12.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
 3. *****, në pozicionin e punës “*Specialist për shërbimin e transportit dhe liçensat*”, në Sektorin e të Ardhurave, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 153, datë 29.09.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
 4. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e të Ardhurave, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 182, datë 29.12.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
 5. *****, në pozicionin e punës “*Inspektor*” në Sektorin e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 112, datë 17.05.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
 6. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë Ekonomike, emëruar me aktin nr. 72, datë 15.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
 7. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 149, datë 01.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
 8. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 62, datë 12.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
 9. *****, në pozicionin e punës “*Administrator për PAK+NE*”, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 66, datë 12.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.

10. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Shërbimit Social, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 120, datë 12.06.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
11. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Strehimi*” në Sektorin e Shërbimit Social, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 68, datë 12.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
12. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Arsimit, Rinisë, Sportit, Shëndetësisë, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 10, datë 01.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
13. *****, në pozicionin e punës “*Specialiste Shëndetësie*” në Sektorin e Arsimit, Rinisë, Sportit, Shëndetësisë, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 58 prot., datë 06.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
14. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Jurist*” në Sektorin e Urbanistikës dhe Menaxhimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 168, datë 17.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
15. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 54, datë 16.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
16. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Jurist*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 90, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
17. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Kadastrë Hartograf*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 92, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
18. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 88, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
19. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Zhvillimit të Projekteve dhe Bashkëpunimit me OJF, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 113, datë 18.05.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.

20. *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës” në Sektorin e Investimeve, Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr. 84, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
21. *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës” në Sektorin e Shërbimeve, Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr. 166, datë 16.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
22. *****, emëruar me aktin nr.135, datë 01.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “Inspektor Shërbimesh” në Drejtorinë e Investimeve dhe Shërbimeve Publike.
23. *****, emëruar me aktin nr.101, datë 02.05.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “Inspektor Shërbimesh Publike” në Drejtorinë e Investimeve dhe Shërbimeve Publike
24. *****, në pozicionin e punës “Specialist i Artit dhe Kulturës” në Sektorin e Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 58, datë 16.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
25. *****, në pozicionin e punës “Specialist Agronom për Ujitjen dhe Kullimin” në Sektorin e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, Drejtoria e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 57, date 16.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Ky punonjës nuk përmbush edhe kriterin arsimor;
26. *****, në pozicionin e punës “Specialist Agronom” në Sektorin e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, Drejtoria e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 148, datë 01.10.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
27. *****, në pozicionin e punës “specialiste” në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 56, datë 16.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
28. *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës” në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 60, datë 16.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
29. *****, në pozicionin e punës “Specialist Arkivist” në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 111, datë 17.05.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;

30. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Arkivist*” në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 83, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
31. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Zyrën e Integruar me një ndalesë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 76, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
32. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Zyrën e Integruar me një ndalesë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 74, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
33. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Zyrën e Integruar me një ndalesë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 184, datë 29.12.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
34. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Zyrën e Integruar me një ndalesë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 20, datë 09.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
35. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Aseteve, Aksioneve dhe Ndërmarrjeve, Drejtoria Juridike dhe Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 81, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
36. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin Ligjor, Drejtoria Juridike dhe Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 244/1, datë 19.11.2016, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
37. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin Ligjor, Drejtoria Juridike dhe Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 86, datë 26.04.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
38. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin Ligjor, Drejtoria Juridike dhe Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 259, datë 01.12.2016, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;
39. *****, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, emëruar me aktin nr. 154, datë 29.09.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës;

40. *****, në pozicionin e punës “*Drejtor*” në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar në mënyrë të përkohshme me aktin nr. 14, 06.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
41. *****, emëruar me aktin nr. 194, datë 03.12.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, në pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”.
42. *****, emëruar me aktin nr. 193, datë 03.12.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Drejtor*” në Drejtorinë Ekonomike.
43. *****, emëruar me kontratën e datës 12.11.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialist jurist*” në Drejtorinë Ekonomike.
44. *****, emëruar me aktin nr. 161, datë 24.07.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialist Vlerësimi*” në Drejtorinë Ekonomike.
45. *****, emëruar me aktin nr. 164 date 03.08.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “Punonjës i Shërbimit Social” pranë Njesisë Administrative Shllak.
46. *****, emëruar me kontratën e datës 01.10.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialist Psikolog për Mbrojtjen e Fëmijëve*” pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.
47. *****, emëruar me aktin nr. 193, datë 03.12.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialist për përfshirjen sociale*” pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
48. *****, emëruar me kontratën e datës 01.10.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Punonjës Social*” pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe PAK.
49. *****, emëruar me kontratën e datës 05.11.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialiste në Sektorin e Arsimit*” pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.
50. *****, emëruar me kontratën e datës 03.11.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialiste në Sektorin e Arsimit*” pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

51. *****, emëruar me aktin nr. 183, datë 27.9.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialist Shërbimesh*” në Drejtorinë e Planifikimit Urban.
 52. *****, emëruar me aktin nr. 163, datë 5.8.2016 të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialist*” në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave.
 53. *****, emëruar me kontratën e datës 14.11.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialiste agronome*” në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave.
 54. *****, emëruar me aktin nr. 166, datë 03.08.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialiste*” në ZIN, Njësia Administrative Bushat.
 55. *****, emëruar me aktin nr. 165, datë 03.12.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialiste*” në Sektorin e Emergjencave Civile.
 56. *****, emëruar me aktin nr. 157, datë 03.07.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Përgjegjëse*” në sektorin e Emergjencave Civile.
 57. *****, emëruar me kontratën e datës 03.11.2018, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në pozicionin e punës “*Specialiste IT*” në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.
- Me qëllim që të mos pengohet veprimtaria normale e institucionit, njësia përgjegjëse, të planifikojë ecurinë e kësaj procedure, duke alternuar veprimin e Kryetarit të Bashkisë për konstatimin si akte absolutisht të pavlefshme, të rasteve të evidentuara më sipër, me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore përkatëse dhe procesi i rregullimit të ligjshmërisë të ndahet në dy faza.
 - Dokumenti i planit të veprimit në këtë rast do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin.
 - Zbatimi i planit të veprimit do të ndiqet nga Sekretariati i Komisionerit, sipas afateve të vendosura në këtë akt.
3. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Bashkinë Vau i Dejës, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas procedurave specifike të përcaktuara në ligj, për punonjësit si më poshtë:*

- ✓ Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësin ***** në pozicionin e punës “*Specialist Veteriner*”, në Sektorin e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural.
 - ✓ Të shfuqizojë vendimin nr 177, datën 21.9.2018, “*Për anulimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ të emërimit në detyrë dhe rregullimin e pasojave juridike*”, për emërimin e ***** si punonjëse me kontratë pranë “*Sektorit të Rregjistrimit dhe Kontabilizimit të të Ardhurave*”
 - ✓ Të anulojë aktin administrativ nr. 19/6, datë 28.07.2016, për deklarimin e statusit të punësimit të punonjësës ***** nëpunëse civile në pozicionin e punës “*Inspektore e Informimit Publik*”, në Njësinë Administrative Bushat, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.
 - ✓ Njësia e menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të nxjerrë aktin e përfundimit të marrëdhënieve të punësimit dhe ato financiare për punonjëset ***** dhe ***** sipas përcaktimeve të pikës 7, të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*”.
 - ✓ Njësia Përgjegjëse të marrë masa për tu plotësuar këto pozicione pune në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Vau i Dejës, gjatë realizimit të procedurave për transferimin e përkohshëm, dhe të përhershëm të nëpunësve civile, të respektojë kërkesat e sanksionuara në vendimin nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*” dhe të veprojë në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
- ✓ Njësia Përgjegjëse të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 73, datë 20.04.2018, “*Për emërimin në detyrë*” të nëpunësit ***** në pozicionin e punës “*Drejtor i Zhvillimit Rural*” në Bashkinë Vau i Dejës, vendim i marrë gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.
 - ✓ Për të rregulluar situatën ligjore, Njësia Përgjegjëse, të nxjerrë aktin administrativ, përmes të cilit të njoftohet institucioni i Bashkisë Shkodër se ka përfunduar afati i transferimit të përkohshëm për nëpunësin ***** duke mundësuar në këtë mënyrë kthimin e tij në pozicionin të cilin mbante para transferimit të përkohshëm, “*Përgjegjës Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve*” në Bashkinë Shkodër.

5. Njësia Përgjegjëse, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të dala gjatë procesit të transferimit të përhershëm, të cilat janë kryer në kundërshtim me nenet 25, 26 dhe 50/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar:
1. Aktit nr. 95, datë 26.04.2018, për transferimin e nëpunësit civil *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Kontrollit Tatimor”.
 2. Aktin nr. 97, datë 26.04.2018, për transferimin e nëpunësit *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit”.
 3. Vendimi nr. 98, datë 26.04.2018, për transferimin e nëpunësit *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë”.
 4. Vendimi nr. 134, datë 12.09.2017, për transferimin e nëpunësit civil *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e të Ardhurave” në Drejtorinë Ekonomike.
- a. Në këtë rast, duhet të vlerësohet nga Njësia Përgjegjëse mundësia e sistemimit të këtyre punonjësve, në pozicionet e punës të cilat mbanin para ristrukturimit ose në pozicione të tjera pune të kategorisë ekzekutive, në të cilat ata i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme.
 - b. Më tej, të vijojë puna duke shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Këta punonjës nuk kanë asnjë pengesë për të konkurruar për procedurën e ngritjes në detyrë në këto pozicione.
 - c. Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.
6. Njësia përgjegjëse, të përfundojë procesin e hartimit të formularëve të përshkrimit të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit për vitin 2019, për të zbatuar detyrimin ligjor të respektimit

të skemës së funksionimit të shërbimit civil, parashikuar në nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil. Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

7. Njësia përgjegjëse, në lidhje me përmbushjen e kërkesave ligjore, në rastin e aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duhet të mbajë në vëmendje procedurën, sipas përcaktimeve të Kreut X *“Disiplina në Shërbimin Civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”* dhe të ngrejë Komisionin e Disiplinës.

- Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të urdhrave për dhënien e masave disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*, e konkretisht:

- ✓ urdhri nr. 31, datë 13.02.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësen *****,
në pozicionin e punës *“Specialiste në Sektorin e Ndhmës Ekonomike”*.
- ✓ urdhri nr. 47, datë 12.03.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësen *****,
në pozicionin e punës *“Specialiste në Sektorin e Ndhmës Ekonomike”*, Njësia Administrative Temal.
- ✓ urdhri nr. 30, datë 13.02.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësen *****,
në pozicionin e punës *“Përgjegjëse në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK”*.
- ✓ urdhri nr. 34, datë 13.02.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësen *****,
në pozicionin e punës *“Specialist në Sektorin e Ndhmës Ekonomike”*, në Njësinë Administrative Bushat.
- ✓ urdhri nr. 52, datë 09.05.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësin *****,
në pozicionin e punës *“Kryeinspektor i IVMT-së”*.
- ✓ urdhri nr. 51, datë 09.05.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësin *****,
në pozicionin e punës *“Inspektor i IVMT-së”*.
- ✓ urdhri nr. 53, datë 09.05.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësin *****,
në pozicionin e punës *“Inspektor i Taksave dhe Tarifave në Sektorin e të Ardhurave”*.
- ✓ urdhri nr. 32, datë 3.02.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësin *****,
në pozicionin e punës *“Specialist i Ndhmës Ekonomike”*, në Njësinë Administrative Hajmel.
- ✓ urdhri nr. 107, datë 12.07.2018, *“Vërejtje me shkrim”*, për punonjësen *****,
në pozicionin e punës Specialiste në Sektorin e Aseteve.

- Kryetari i Bashkisë të referojë kërkesën për fillimin e ecurisë disiplinore, në rastin e një mase disiplinore vërejtje, tek eprori direkt i nëpunësve të cilët pretendohet se kanë kryer shkelje disiplinore të kategorizuara si të lehta, ose pranë Komisionit të

Disiplinës, në rastet e tjera kur shkelja pretendohet të jetë e kategorië, e rëndë ose shumë e rëndë.

- Njësia Përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të rregullojë pasojat e ardhura nga këto akte, duke hequr nga dosja personale e nëpunësve të sipërcituar urdhrat për dhënien e masave disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*.
- 8.** Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 dhe në vijim, për vitin 2019, si dhe të ndjekë procesin për të respektuar afatet, duke orientuar edhe aktorët e tjerë të procesit, ndër të cilët eprorët e drejtpërdrejtë, sipas raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil.

- 9.** Njësia përgjegjëse e institucionit, për vitin në vijim, të marri masat për të finalizuar miratimin e planit vjetor të pranimeve të reja në shërbimin civil, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*, si dhe bazuar në orientimet e Komisionerit në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.

Kryetari i Bashkisë të finalizojë procesin në këtë rast, duke e miratuar projektin e planit të rekrutimit të propozuar nga njësia përgjegjëse.

- 10.** Njësia Përgjegjëse të njoftojë për këtë vendim të gjithë subjektet e ngarkuara me detyra specifike prej ligjit për nëpunësin civil, për administrimin e shërbimit civil në rolin e Eprorit Direkt, Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues dhe Zyrtarit Autorizues, në këtë institucion, të cilët do të mbajnë përgjegjësi personale për mos respektimin e kërkesave të ligjit për nëpunësin civil, në rast se nuk veprojnë për të rivendosur ligjshmërinë brenda afatit të vendosur nga Komisioneri për zbatimin e këtij vendimi, në të gjitha institutet e ligjit, që janë evidentuar me parregullsi.

Po kështu, njësia përgjegjëse duhet të njoftojë për këtë vendim të gjithë punonjësit e ngarkuar prej ligjit me hartimin e formularëve të përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.

- 11.** Njësia përgjegjëse për të siguruar një administrim efikas të shërbimit civil, duhet të plotësojë të gjitha mangësitë e konstatuara në dosjet e personelit, në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për*

përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe me shënimet në anekset që janë pjesë e këtij raporti.

- 12.** Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
- 13.** Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vau i Dejës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të paraqesin të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.
- 14.** Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës dhe Njësia Përgjegjëse, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Ministria e Brendshme.
- 15.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha